



ROMANIA
Ministry of Foreign Affairs



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

14 Shkurt 2011

Unofficial translation

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

KTHIMI/KOMPENSIMI I PRONAVE: MASA TË PËRGJITHSHME NË PËRSHTATJE ME VENDIMET E GJYKATËS EVROPIANE

**Organizuar me mbështetjen financiare të 'Human Rights Trust Fund'
në kuadër të projektit "Eliminimi i pengesave për zbatimin e vendimeve
gjyqësore vendase/Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimeve gjyqësore vendase"**

Bukuresht, Howard Johnson Hotel,
5-7 Calea Dorobantilor Dist. 1, Bukuresht, 010551 Rumani

17 Shkurt 2011

DRAFT PROGRAM

8.00 – 9:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

Kryesues: Zj Răzvan-Horațiu Radu, Zv. Sekretar Shteti, Agjent Qeveritar pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ministria e Punëve të Jashtme, Rumani

9: 00 – 9:50 Hapja e konferencës¹

Fjala e mirëseardhjes nga:

Zj Cătălin Predoiu, Ministri i Drejtësisë, Rumani

Zj Livia Doina Stanciu, Kryetare e Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë, Rumani

Zj Titus Corlățean, Kyetar i Komitetit të Cështjeve të Jashtme, Senati i Rumanisë

Zj Geneviève Mayer, Drejtuese e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës

¹ Sesioni i hapjes është i hapur për shtypin.

9:50 – 10:45 Krijimi i skenës: Kthimi/kompensimi i pronave dhe perspektiva Evropiane

Kryesues: Z Gyorgy Frunda, President i Komitetit për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet, Senati i Rumanisë, anëtar i delegacionit Rumun, në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kërkesat e Konventës dhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e kthimit/kompenzimit të pronave: Prezantim i përgjithshëm i praktikës së Gjykatës Evropiane me referencë të vecantë në “gjkimin pilot” *Maria Atanasiu dhe të tjerët k. Rumansë*, vendim i datës 12 Tetor 2010:

Z Santiago Quesada, Sekretar i Seksionit III të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Sfidat lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane në lidhje me kthimin/kompenzimin e pronës

Z Fredrik Sundberg,, Zv/ Drejtues i Departamentit, Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës

Diskutime

10:45 – 11:15 Pushim/Kafe

11:15 – 13:00 Shkëmbim Eksperience: Sfida lidhur me kthimin/kompenzimin e pronës në nivel kombëtr

Kryesues: Z Răzvan-Horațiu Radu, Zv. Sekretar Shteti, Agjent Qeveritar pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ministria e Punëve të Jashtme, Rumani

Prezantimet nga vendet pjesëmarrëse (10-15 minuta) do të bëhen nga pjesëmarrës të nivelit të lartë në lidhje me eksperiencën e tyre lidhur me kthimin/kompenzimin e pronës së shtetëzuar përpara vitit 1989. Pëe më tëpër, prezantuesit janë të inkurajuar të ndajnë eksperiencat më të mira dhe vështirësitë e hasura në vendet e tyre. Ata janë të inkurajuar të ndajnë eksperiencat e tyre në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e kthimit/kompenzimit të pronës.

- Prezantimi i Z Alexandru Tanase, Minister i Drejtësisë, Moldavi
- Prezantimi i Z Alfred Rushaj, Zv/Ministër i Financave, Shqipëri
- Prezantimi i Zj Daniela Masheva, Zv/Ministre e Drejtësisë, Bullgari
- Prezantimi i Z Piotr Styczen, Zv/Ministër i Infrastrukturës, Poloni
- Prezantim i Zj Crinuta Dumitrean, Drejtuese e Agjencisë Kombëtare të Kthimit të Pronave, Rumani

Diskutime

13:00 – 14:30 Pushim/Drekë

14:30 – 17:00 Tryeza të Rrumbullakta (organizuar paralelisht)

Tryeza 1: Kuadri legjislativ: procesi ligjvenes lidhur me kthimin/kompensimin e pronave dhe sfidat lidhur me të

Kryesues: Z Tudor Pantiru, ish gjyqtar i GjEDNj, President i nën komitetit për mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane , Parlamenti i Rumanisë

Z Fredrik Sundberg,, Zv/ Drejues i Departamentit, Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës

Raportues: Z Jakub Wołasiwicz, Agjent Qeveritar pranë GjEDNj, Poloni

Prezantime të shkurtra prezantuese (10 minuta) nga:

- Z Harald Koenig, Zyra Federale për Shërbime Qendrore dhe Cështje të Pazgjidhura të Pronësisë, Gjermani
- Z Tomasz Kuchenbeker, Këshilltar Ligjor, Ministria e Thesarit, Poloni
- Zj Mija Cankar, Krye Këshilltare Ligjore, Ministria e Drejtësisë, Slloveni
- Gábor Czepek, Shef i Departamentit të të Drejtës Private dhe Drejtësisë , Hungari

Ndjekur nga diskutime dhe/ose prezantime të tjera

Cështjet që duhet të adresohen:

Prezantimet dhe diskutimet do të përqendrohen në praktikat më të mira dhe vështirësitë e hasura në procesin e hartimit të legjislacionit lidhur me kthimin/kompensimin e pronës. Nga pjesëmarrësit duhet të adresohet nevoja e kryerjes së një vlerësimi përpara hartimit të legjislacionit mbi kthimin/kompensimin e pronës, të cilët janë të ftuar të ndajnë eksperiencat e tyre në këtë aspekt. Prezantimet duhet të japin një pamje të përgjithshme të zgjidhjeve të ndryshme që mund të parashikohen (kthimi dhe/ose kompensimi) ngritjen institucionale dhe sistemet e vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë. Pritet gjithashtu që prezantuesit të adresojnë kushtetet për dhënien e kompensimit (në para apo natyrë), kriteret e kualifikimit, nivelin e kompensimit (vlerë të plotë të tregut apo kompensimin të përcaktuar) si dhe formën e pagesës (pagesë të vetme apo në këste). Cështja e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve administrative mbi kthimin/kompensimin e pronës, është e të njëjtit interes. Folësit janë gjithashtu të ftuar të ndajnë eksperiencat e tyre lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e kthimit/kompensimit të pronës

Tryeza 2: Masat Zbatuese: kthimi/kompensimi i pronës dhe sfidat lidhur me të

Kryesues: Z Vít Schorm, Agjent Qeveritar pranë GjEDNj, Republika Çeke

Bashkë kryesuese: Zj Dimitrina Lilovska, Drejtuese Seksioni, Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës

Raportuese: Zj Štefica Stažnik, Agjente Qeveritare pranë GjEDNj, Kroaci

Prezantime të shkurtra prezantuese (10 minuta) nga:

- Z Irmantas Jarukaitis, Gjyqtare e Gjykatës Supreme, Lituani
- Zj Ledina Mandia, Avokate e Përgjithshme e Shtetit, Shqipëri
- Zj Laila Medina, Zv/Sekretare Shteti, Letoni

- Z Tomáš Doucha, Zv/Drejtor i Institutit të Ekonomisë Agrare dhe Informacionit, Republika Ceke

Ndjekur nga diskutime dhe/ose prezantime të tjera

Cështjet qe duhet të adresohen:

Prezantimet dhe diskutimet do të përqendrohen në praktikat më të mira dhe vështirësitë e hasura në implementimin e legjislacionit përkatës dhe probleme që janë hasur në këtë proces. Masat lidhur me mënyrën e dhënies së kompensimit (në natyrë dhe financiar) dhe pagimit të kompensimit – në mënyrë të vecantë masat e marra për të siguruar fondet e nevojshme dhe vështirësitë e hasura në këtë aspekt, duhet të ndahen midis pjesëmarrësve. Do të diskutohet gjithashtu edhe eksperiencia e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve lidhur me kthimin/kompensimin e pronës, kompetencat e këtyre organeve, procedurat përkatëse dhe disponueshmëria e burimeve njerëzore e financiare. Pritet gjithashtu që pjesëmarrësit të shkëmbejnë eksperiencat e tyre lidhur me interpretimin e legjislacionit të kthimit/kompensimit të pronave nga organet administrative dhe gjykatat lokale. Folësit janë gjithashtu të ftuar të ndjanë eksperiencat e tyre lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e kthimit/kompensimit të pronës.

17:00 – 17:30 Pushim/Kafe

17:30 – 18:30

Seancë Plenare: Raportimet nga dy tryezat dhe konkluzionet

Kryesues: Zj Cynthia Curt, Sekretare Shteti, Kryetare e Grupit të Punës NdërMinistror mbi Cështjet e Pronësisë, Zyra e Kryeministrit, Rumani

Prezantimi i permbledhjes së diskutimeve nga dy tryezat

- Tryeza 1: Z Jakub Wołasiwicz, Agjent Qeveritar praën GjEDNj, Poloni
- Tryeza 2: Zj Štefica Stažnik, Agjente Qeveritare prane GjEDNj, Kroaci

Prezantimi i konkluzioneve të tryezës së rrumbullkët nga Zj Geneviève Mayer, Drejtuese e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës

18:30 **Mbyllja e Tryezës së Rrumbullakët** ndjekur nga Pritja e ofruar nga Autoritetet Rumune
